



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 09.02.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR

Baza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreut IV, pika 1, të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2026 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e kriterëve mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind, si më poshtë:

- a) Familjet në nevojë që për zgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar, për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - b) Përfitues do të jenë aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - c) Familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar, me prioritet si: familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, familje me 1 (një) anëtar dhe gratë kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim., familje pa të ardhura, të moshuar të vetmua, rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe me fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
- a) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës përpunojnë listën e përfituesve dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
 - b) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës dhe Njësitë Administrative dërgojnë projektvendimet çdo muaj pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale Durrës, e cila harton listën e përfituesve të mundshëm.
 - c) Njësitë administrative propozojnë fondin e kushtëzuar për çdo familje, referuar Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017, të Ministrat të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar.
 - d) Njësitë administrative konfirmojnë shkresërisht çdo muaj, pas zbardhjes së vendimit për ndihmën ekonomike, listën e personave, që do të vazhdojnë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor mbi bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind.
 - e) Drejtoria e Shërbimeve Sociale, harton projektvendimin për familjet në nevojë, që do të trajtohen në bazë të vlerësimit social-ekonomik dhe propozimeve të bëra nga njësitë administrative dhe lagjet, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.
3. Të miratojë dokumentacionin që duhet të plotësojë Administratori Social mbi aplikimin e përfitimit nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
- a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti;
 - b) Certifikatën familjare që lidhet me regjistrin e familjes, për të gjithë ata persona që janë pjesë e të njëjtës gjendje familjare;
 - c) Dokumenta të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare;
 - d) Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesit shoqëror, për rastet e parashikuara;
 - e) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara;
 - f) Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqiten për të përfituar ndihmën ekonomike janë në proces zgjidhjeje martesore;

- g) Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;
 - h) Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentacionet e tjera;
 - i) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;
 - j) Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues.
4. Dokumentacioni shkresor nga Njësitë Administrative përmban:
- a) Listën përmbledhëse emërore të përfituesve të mundshëm, sipas shtojcës nr. 4, të VKM-së 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar;
 - b) Tabela përmbledhëse mbi numrin e familjeve dhe fondin e parashikuar.
5. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përlllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike”, i ndryshuar.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

-

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale.

Impakti social/grupet që preken:

Familjet të cilat jetojnë në territorin e bashkisë Durrës, të cilat përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6% dhe ato që janë në kushte të vështira ekonomike dhe që përfitojnë nga të ardhurat e bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mbledhë më datë 09.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 1 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 09.02.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHETIT, TË PASHPËRNDARA NË VITIN 2025, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2026 .

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 19.12.2025 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkinë Durrës”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 19.12.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 30.12.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzim Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Fondet e përfituara nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.762, datë 19.12.2025, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.767, datë 19.12.2025 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.816, datë 30.12.2025, në total me vlerë 320,423,765 lekë dhe i pashpërndarë në vitin 2025, trashëgohet në vitin 2026 dhe do të përdoret sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

N r.	VKM që ka miratuar fondin	Emërtimi i produktit	Kodi i produktit	Kapitull	Program	Llogaria ekonomike	Fondi sipas VKM	Vlera e mbartur nga 2025
1	VKM nr. 762 dt. 19.12.2025	Rikonstruksion/rip arim i banesave individuale, i mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa te njesive te banimit	94902AB	1	04960	606	169,850,000	169,850,000
2	VKM nr. 767 dt. 19.12.2025	Shpronësim për zhvillimin e njësive pas tërmetit	94902AG	1	4960	231	13,929,889	13,929,889
3	VKM nr. 816 dt. 30.12.2025	Rindertim I banesave individuale	94902AC	1	04960	606	341,609,690	136,643,876
		TOTALI						320,423,765

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Ligjore, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondet e përfituara nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike .

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 09.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 3 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetori hapri mbledhjen nëse ka pyetje
Pyetje nuk ka nga anëtarët e prezencës dhe
presidentit jasht diskutimit.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:


T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar

Rolant Xhelilaj

PRO 

Zv/Kryetar

Erzen Laçi

Sekretar

Hekuran Markola

PRO

Anëtar

Jonada Mamo

PRO Denis Lika PRO


Anëtar

Alfred Mullaraj

PRO

Anëtar

Kastriot Xhongoli

PRO 

Anëtar

Silvana Agasi

PRO 

Anëtar

Dritan Burgija

Anëtar

Jonuz Myshketa

Anëtar

Xhojana Gjineci

Anëtar

Kontjana Kuçi